



2022-2024

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 VEHERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Njësia Orig. / 01/3 / Nr. Prof. / 2820
 C/S. Jesh. / / Rr. Prof. /
 C/S. Unit. / / P-u/I.No. /
 No. / / Datm. / 02-11-21
 Broj. Kthimje. / / Datm. /
 No. Detyr. / / Datm. /

PRISHTINE A NO. 1

PLANI I BIZNESIT



KOMPANIA RAJONALE E UJES, ELLESIT
 REGIONALE KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE
 »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 01-02/01
 Dt. 29.10 2021
 PRIZREN

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

Tel/ Fax : 029/ 244 150

E-Mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

www.hidroregjioni-jugor.com

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 LEBERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 Ministry of Economy

Njësia Org. 0113 No. Pr. d. 2820
 Org. Jedin. Pr. No. 02.11.21
 Nr. i faqes 1 Datum:
 Broj strana 1 Datum:
 No. pages 1 Datum:

PRISHTINE A NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA YDOSCASBOEVANIE

»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 01-02/01
 Dt. 29.10.2021
 PRIZREN



Kompania Rajonale e Ujësllësit

“Hidroregjioni Jugor” SH.A.

“Vatrat Shqiptare”, p.n. 20000 Prizren

Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107

E-mail; sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com


Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësllësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Plan-Biznesnë si dhe në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike për Plan-Biznes, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2021 mori këtë:

PLAN-BIZNESI 2022-2024

Vendimi : 01-02/01

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve njëzëri miratoi Plan Biznesin e KRU” Hidroregjioni Jugor” Sh.A, për vitin 2022-2024 duke përfshirë edhe Strukturën Organizative të Kompanisë, në mbledhjen e 2(dytë) të mbajtur me datë 29.10.2021.

	Delegoi	Approv
Emri Mbiemri	UD.Kryeshefi Ekzekutiv Zenel Zenelaj	Kryesuesi e BpD Arbëror Prekazi
Nënshkrimi		
Data	29.10.2021	29.10.2021



PËRMBAJTJA

HYRJE

1	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	5
1.1	Historiku i Kompanisë	5
1.2	Deklerata e politikës	6
1.3	Deklerata e „misionit“	6
1.4	Tarifat e shërbimit	7
2	DEPARTAMENTI TEKNIK	8
2.1	Qëllimet dhe objektivat kryesore	8
2.2	Aktivitetet kryesore nga Sh. Teknik	10
2.3	Rreziqet për mos arritjen e caqeve	11
2.4	Plani i minvestimeve kapitale	12
2.5	Perteritja dhe rritja e infrastruktures	13
2.6	Planifikimi i zvoglimit të UPF-se	14
2.7	Plani i menaxhimit të asetëve	14
2.8	Prodhimi – 2022-2024	15
3	DEPARTAMENTI RAJONAL PËR KONSUMATORË	16
3.1.1	Parashikimi i Kërkesës për ujë dhe rritja e konsumatorëve	17
3.1.2	Numri i Konsumatorëve- 2022-2024- KRU- HJ	18
3.1.3	Faturimi m3- 2022-2024- KRU- HJ	19
3.1.4	Faturimi € - 2022-2024	20
3.1.5	Arkëtimi € - 2022-2024	22
3.1.6	Masat e propozuar për arritjen e objektivave - SHPK	23
3.2	Gadishmëria për të paguar	24
3.3	Trendet e kërkesave me të shpeshta për konsumatorë	24
3.4	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve	25
3.5	Rregullimi/ konvertimi i lidhjeve të paligjshme	25
3.6	Plani operacional	26
3.6.1	Planifikimi i zgjerimit të shërbimeve	26

4	SHËRBIMI I FINANCAVE	26
4.1	Analiza e shpenzimeve	26
4.2	Planifikimi i shpenzimeve	27
4.3	Arsyeshmeria e shpenzimeve	28
4.4	Planifikimi i kostos per ITUZ- Prizren	29
4.5	Parashikimi i reziqeve financiare	29
4.6	Masat e planifikuara per arritjen e objektivave	29
4.7	Planifikimi i bonuseve dhe shperblimeve	30
4.8	Treguesit kryesor të performancës- 2022-2024	30
5	Plani i zhvillimit të stafit	31
6	Analiza SWOT	32
7	Performanca operative dhe financiare	34
8	Investimet 2022-2024	37
9	Analizat e ujit – 2022-2024	38
	ORGANOGRAMI	39

HYRJE

Plani i Biznesit për vitin 2022-2024 është një planifikim i caqeve kryesore të Kompanisë bazuar në një Modul i përgatitur paraprakisht. Planifikimi i caqeve bazohet në synimet e të gjitha Njësive punuese, në baza mujore dhe vjetore.

(Ekziston nje modul i plote ne baza mujore)

Gjatë përgatitjes së këtij revidimi të Planit të Biznesit janë angazhuar të gjitha shërbimet përkatëse të Kompanisë.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar planifikimeve mujore të të gjitha performacave e veçanërisht atyre operative dhe financiare.

Forma e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit është bazuar edhe në kërkesat për raportim nga ARRU si dhe institucionet tjera.

Qëllimi kryesorë i këtij moduli është thjeshtëzimi i mënyrës së kontrollit të performancave duke filluar nga shërbimet e caktuara, Njësitë Punuese e deri tek niveli regjional.

Ky Plan definoi qartë orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe objektivat si dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake.

Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë, trendet e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë si dhe jashtë Kosovës për të adoptuar praktikatat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë.

Plani i Biznesit 2022-2024 definoi qartë rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojë me një arritje të vetë qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë. Parametrat financiar dhe operativ janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme (duke lënë mundësinë e tejkalimit të të njëjtave) dhe të jenë sa më afër realitetit.

Plani i Biznesit është i orientuar fuqishëm edhe në drejtim të Institucioneve financiare dhe Donatorëve ku realizimi i këtij plani, e sidomos i Planit të investimeve kapitale është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga Donatorët, Institucionet financiare si dhe institucionet qendrore dhe lokale.

1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

1.1 Historiku i Kompanise

Në vitin 1962 ka filluar të ushtrojë veprimtarinë e saj si ndërmarrje Shoqërore e njohur me emrin “Cvileni”, që nga viti 1999 ka funksionuar si Ndërmarrje Publike nën DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndërsa që nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani është regjionalizuar me 4 njësi në vete: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga Korriku i vitit 2007 funksionon si Shoqëri Aksionare K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” S.H.A.

Kompania e ujësjellësit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- **Komuna e Prizrenit** - Qyteti i Prizrenit dhe 31 Fshatra
(Numri total i fshatrave- 72)
- **Komuna e Suharekës** – Qyteti i Suharekës dhe 22 Fshatra
(Numri total i fshatrave – 42)
- **Komuna e Dragashit** – Qyteit i Dragashit dhe 3 Fshatra
(Numri total i fshatrave - 38)
- **Komuna e Malishevës** – Qyteti i Malishevës dhe 19 Fshatra
(Numri total i fshatrave - 44)
- **Komuna e Mamushës**

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operationale dhe 5 Komuna: Prizren, Suharekë, Dragash , Malishevë dhe Mamushë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel te Kompanisë furnizohen edhe 71 fshatra që janë të kyçur ne rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Kapaciteti prodhues përfshinë kapacitetet përmes puseve të cilat janë alternativë si dhe burimet të cilat nuk janë të shfrytëzuara aktualisht me kapacitet të plotë. Furnizimi bëhet 45% pompa, 55% me gravitet.

1.2 Deklarata e politikës

Menaxhmenti i KUR "Hidroregjioni Jugor" SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe zhduken në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogëlimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përmbushja e një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

1.3 Deklarata e "misionit"

Misioni i KUR "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do të ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes.

Trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, përkatësi religjioze, kombëtare dhe gjinore.

Duke përmbushur këtë "mision" do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti të vetë financueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtorëve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministria e Financave,
- ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)
- Konsumatorët (të organizuar në komisione, shoqata etj).

1.4 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do ta vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina sipas Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është përcaktuar “mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve”

Tarifat e miratuara nga ARRU do të jenë ekskluzivisht në funksion të mbulimit të shpenzimeve operative, rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët. Rritjet e reja do të ndikojnë pozitivisht dhe do të mobilizojnë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR “Hidroregjioni Jugor” SH.A. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

TARIFAT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA 2021

Tabela. 1 Tabela e tarifave aktuale per vitin 2021

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike per ujë të pijes (Euro/m3)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom3)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.38	0.14
Konsumatori Komercial/Industrial	2.0	0.67	0.32
Konsumatori institucional	2.0	0.67	0.32

Koment: Ne raste te ndryshimit te vendimit nga ARRU, do te llogariten caqet bazuar ne ndryshimet eventuale

2. DEPARTAMENTI TEKNIK

2.1 Qëllimet dhe Objektivat kryesore

- Zgjerim të zonës shërbyese (96 %) me synim të rritjes së përqindjes së popullatës në qasje të shërbimeve me ujë të pijes dhe kanalizime duke përmbushur kriteret e ndikimit ambiental dhe ngritjes së mirëqenies socioekonomike për popullatën brenda zonës së shërbimit,
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Sigurimin e furnizimit me ujë të konsumatorëve ekzistues dhe atyre të ri në 24 orë dhe rregullimin e presionit sipas standardeve aplikative për të gjitha zonat sikurse dhe zonat problematike të furnizimit.
- Sigurimin e furnizimit me ujë të cilësisë dhe kualitetit në pajtim me standardet e IKSHPK-se, gjegjësisht 100% pajtueshmërinë e testeve të ujit;
- Zgjerimi i zonës së shërbimit në trajtimin e ujërave të ndotura përmes planifikimit dhe inicimit të projekteve për ndërtimin e ITUN-ve parciale dhe qendrore..
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë
- Afarizmin rentabil me vetëqëndrueshmëri financiare, përmes rritjes së normës së mbulesës së punës;
- Rritja e vlerës së asetëve për periudhën 2022-2024
- Zbatueshmëri e plotë të Rregulloreve të ARRU përfshirë Standardet Minimale të Shërbimeve, Licencimit, Kartën e Konsumatorëve, Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve si dhe arritjen e të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimet e domosdomshme vjetore që përcaktohen nga Planifikimi i ardhshëm i Menaxhimit të Asetëve;
- Përmirësimi i dukshëm dhe avansimi i furnizimit me ujë
- Kontrolli permanent i cilësisë së ujit dhe presionit konform standardeve në fuqi
- Zvogëlimi optimal i humbjet teknike e komerciale
- Shtimi i konsumatoreve të rinjë
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative të mirëmbajtjes e operimit
- Shtimi dhe avansimi i shërbimeve të Kompanisë
- Preventimi i mundësisë së ndotjes së ujit të pijes nga ujërat e zeza

- Funksionimi i plote dhe efikas i rrjetit te ujesjellesit dhe kanalizimit
- Mirëmbajtja dhe operimi i rregullt i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Sanimi dhe aftesimi kualitativ dhe ne kohe i te gjitha prishjeve ne ujesjelles dhe kanalizim
- Zhvillim i strategjive permes aktiviteteteve te ndryshme per zvogelimin e humbjeve te ujit te pijes, ne theks te vecant vendosja e ujemat esve te konsumatoreve ne prone publike per te pamundesuar keqperdorimin e ujit,
- Implementimi i te gjitha projekteve te planifikuara per vitet 2022-2024, me theks te vecante per vitin 2022,
- Zonimi i sistemit te ujesjellesit per te siguruar furnizim conform standarteve te kerkuara,
- Formimi i DMA zonave dhe aplikimin e modelimeve hidraulike qe mundesojne analizat dhe studimet e mirefillta teknike me objektiv ne zvogelimin e humbjeve teknike dhe administrative,
- Krijimin e ambientit të favorshëm dhe sigurise ne pune për të gjithë të punësuarit;
- Sigurimin e stabilimenteve e paisjeve të teknologjie moderne, të cilat përdoren për kryerjen e aktiviteteteve të Kompanisë, dhe qe permbushin kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit.
- Regjistrimin dhe ruajtjen elektronike e fizike të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të Kompanisë dhe organizimin e tyre në Sistem Informativ Menaxhues e funksional;
- Monitorimin e saktë të prodhimit dhe furnizimit te ujit si dhe grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura përmes pajsjeve matëse të instaluara në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit duke përfshirë edhe sistemet elektronike monitoruese SCADA;
- Vazhdimin e avancimit të sistemit të të dhënave gjeografike (GIS) për të përfshirë tërë zonën e shërbimit dhe hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve;
- Operimi funksional i MMS - Sistemi i menaxhimit te mirembajtjes e operimit, i cili mundeson menaxhimin e urdheresave dhe permbylljen e tyre duke gjeneruar raportet perkatese.
- Operimi funksional i MMA - Aplikacioni mobil per menaxhimin e mirembajtjes e operimit.

- Rritja e transparencës në raportimet të cilat i përgatite Kompania ndaj menaxhmentit, Bordit dhe palëve të treta të interesuara;
- Finalizimi i dy dokumenteve në proces të cilat kanë të bëjnë me: -Menaxhimin e Krizave dhe Menaxhimin e rrezikut.

2.2 Aktivitetet e planifikuara

Aktivitetet e planifikuara janë në funksion të realizimit të projekteve të parapara në këtë Plan Biznes të cilat do të ndikojnë drejtperdrejt në realizimin e çaqeve:

- Realizimi i projekteve investive konform Planit të Biznesit
- Participimi financiar dhe mbështetja e plote profesionale për realizimin e projekteve të kësaj fusheveprimtarie të planifikuara nga institucionet lokale, qendrore dhe tjera.
- Operimi optimal i të gjitha shërbimeve teknike në funksion të sigurimit dhe furnizimit të qendrueshëm, kualitativ dhe cilësor me ujë të pijes.
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura,
- Intervenimi efikas, profesional dhe eficient në sanimin e prishjeve apo pengesave në funksionim të infrastruktures ujore me qëllim të zvogëlimit të humbjeve
- Aktivitetet në instalimin e ujëmatesve të prodhimit dhe ujëmatesve zonal në të gjitha pikat prodhuese e distributive të rrjetit të cilat do të mundësojnë monitorimin e sakte të prodhimit dhe furnizimit të ujit,
- Instalimi i ujëmatesve të të gjithë konsumatorëve dhe përpjekjet e pandërprera që çdo konsumatori t'i matet sasia e ujit të shpenzuar dhe t'i bëhet faturimi në bazë të shpenzimit real,
- Dislokimi i ujëmatesve ekzistues nga prona private në prone publike sa më afër gypit furnizues, me qëllim të preventimit të keqperdorimeve apo nderhyrjeve të palejuara në rrjetin e ujit të pijes,
- Studimi i fisibilitetit për Implementimin e sistemit SCADA për monitorimin dhe menaxhimin e avansuar teknik operacional të prodhimit e furnizimit të ujit të pijes.
- Avansiumin profesional e ekspeditiv të ekipeve të mirëmbajtjes së stabilimenteve Elektroteknike – Mekanike e Hidraulike,
- Pasurimi dhe azhurnimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja,
- Trajnimi dhe avansimi profesional i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkëkohore të trajtimit të ujërave të pijshëm dhe ujërave të zeza
- Zbatimi i rregulloreve të hartuara nga zyra e rregullatorit në lidhje me menaxhimin dhe funksionimin e sistemeve të ujërave të ndotura

- Zbatimi i udhëzimeve administrative për shkarkimet e ujerave të ndotura në sistem dhe trajtimin e tyre si parakusht i domosdoshëm për derdhje në recipient me leshimin në operim të ITUN, në viotin 2021.
- Avansimi dhe ngritja profesionale e stafit punës përmes trajnimeve përkatëse profesionale, studimeve të avansuara, pjesëmarrjes në konferenca dhe aktivitete që trajtojnë këtë fushëveprimtari për të qenë koherent me zhvillimet teknologjike e humane..
- Zbatimin dhe jetesimin e dokumenteve përkatësisht planeve në dispozicion të miratuara dhe në hartim e sipër mbi rreziqet e mundshme:
 1. Planin e menaxhimit të thatësirave,
 2. Planin e furnizimit me ujë të pijes në situata emergjente,
 3. Planin e investimeve afatgjata,
 4. Në proces të hartimit dhe finalizimit të planeve të Menaxhimit të rrezikut dhe Menaxhimit të Krizave.

2.3 Rreziqet që mund të ndikojnë në mosarritjen e cagueve

- Mosrealizimi i investimeve të parapara në plan biznes,
- Prolongimi i projekteve bashkefinansuese për shkak të deshtimit të investimeve nga institucionet qendrore e lokale dhe agjencionet tjera financiare.
- Vazhdimi i efektit të pandemisë apo fatkeqesive tjera natyrore.
- Eficienca operative në aspektin e sanimit të prishjeve e cila mund të rezultojë në sigurinë e cilësisë së ujit, shtypjes dhe furnizimit të rregullt me ujë të pijes, dhe në plotësimin e standarteve minimale të shërbimit dhe mirëmbajtje të kanalizimit.
- Pengesat objektive operacionale të programeve aplikative për GIS dhe aplikacioneve MMS dhe MMA, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në mirëmbajtjen e aseteve të kompanisë,
- Legjislatura e pamjaftueshme që mbulon këtë fushëveprimtari dhe mosazhureteti i organeve të drejtësisë për ndjekjen e keqperdoruesve dhe shkelësve të ligjit.

2.4 Plani i investimeve kapitale

Plani i Investimeve është pjese e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë dhe avansojë shërbimet ndaj konsumatore dhe sensibilizimin e përgjegjësise qytetare për pagesat e faturave ujore.

Plani i investimeve përbëhet prej disa kategori projektesh dhe burimesh financiare me theks të vecante në përmirësimin dhe avansimin e gjithëmbarsheve të infrastrukturës ujore, zgjerimin e zonave shërbyese, zvogelimin e humbjeve dhe avansimin e programeve aplikative monitoruese, menaxhuese e operative.

Varesisht prej mundësive buxhetore dhe vlerave të percaktuara nga ARRU, janë percaktuar projektet me financim vetiak, projektet me participim me agjencionet tjera financiare sikurse dhe projektet madhore, që kalojnë dimensionet dhe mundësitë financiare të Kompanisë dhe që janë referuar strategjive zhvillimore lokale, nacionale e më gjere dhe burimeve tjera financiare që mbulojnë këto fusheveprimtari.

Qëllimi i Planit të Investimeve konsiston në percaktimin e konturave zhvillimore konform orientimeve strategjike dhe planifikimeve të bazuara për përmbushjen e misionit dhe vizionit të Kompanisë.

Percaktimi dhe për zgjedhja e projekteve investive është rezultuar kryesisht në baze të:

- Infrastruktureve të gjithëmbarsheve të dhenave në dispozicion.
- dokumenteve analitike të financiare,
- elaboretive fisibile të studimore,
- raporteve të auditave periodike të vjetore
- vlerësimeve të licencuara të gjendjes së asetëve në dispozicion
- Programeve aplikative operacionale, të shërbimeve të mirëmbajtjes e operimit dhe shërbimeve tjera të Kompanisë.

Pjese integrale e aktiviteteve është harmonizimi me strategjitë zhvillimore komunale e qendrore dhe projektet mbështetëse nga donacionet apo institucionet tjera financiare.

Potencialët financiarë planifikohen të jenë projektet investive të planifikuara nga:

- Linjat e planifikuara buxhetore të investimeve kapitale nga komuna e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit.
- Projektet kapitale të strategjisë nacionale (**ME, MF, MIPH, etj**) dhe modalitetet bashkefinancuese si programet PIP apo ngkajshem
- Mjetet vetanake (nga Kompania)
- Grantet nga institucionet zhvillimore financiare apo agjencionet tjera që mbulojnë dhe përkrahin këto fusheveprimtari sikurse janë:

- **KIW-** Projekt i grumbullimit dhe trajtimit të ujerave të ndotura dhe Eficienca e energjisë elektrike, Faza V dhe VI- Rehabilitimi i rrjetit në sistemin ekzistues të kanalizimit.
- **CDI & DORSCH** Programi për rehabilitimin e zonave rurale

(shiko shtesën: Investimet e planifikura 2022-2024)

2.5 Përtëritja dhe rritja e infrastrukturës

Rajoni i Prizrenit dhe hapësira menaxhuese e Kompanisë identifikohet me dominim të rrjetit të vjetër, të ndërtuar në periudha të ndryshme kohore, viteve 60-ta (parcialisht edhe më heret), materiale të konsumuar nga koha dhe standarde teknike të tejkaluara.

Nevojat investive në këtë drejtim janë shumë të mëdha, të domosdoshme por që kanë kosto të konsiderueshme. Ky aktivitet mund të realizohet pjesërisht nga Kompania por mëjaftueshem vetëm me involvimin dhe mbështetjen e institucioneve lokale, qendrore, Institucioneve financiare zhvillimore të jashtme dhe donacioneve potenciale.

Realizimi planifikohet në fazë sipas mundësive financiare dhe prioritetëve

Percaktimin e prioritetëve dhe nevojave emergjente investive në ripërtëritjen e infrastrukturës së ujësjes dhe të determinojnë raportet, analizat teknike e studimet përkatëse të segmenteve ku janë konstatuar prishje të shpeshta, humbje teknike, lidhje ilegale, presion jashtë standardeve, rrjete të amortizuara, përmbajtje me efekte negative shëndetësore etj..

Me zgjerimin e zonës shërbyese, konform marrëveshjeve paraprake sipas praktikës së deritashme, parashihen dhe investime në trasa të reja furnizuese, burime të reja të ujit, aftësime dhe rehabilitime të rrjetave ekzistuese jofunksionale e të ngjajshme.

Pjesë integrale e këtyre investimeve janë përmirësimi dhe vendosja e infrastrukturës së re të kanalizimit të vendeve rurale por edhe në disa lagje periferike, me derdhje të ujerave të ndotura jashtë kriterëve të lejuara të cilat kanë efekt negativ sidomos në ndotje të ujërave sipërfaqësore, burim të epidemive e rreziqe tjera. Këto planifikime investive synojnë përmbushjen e kriterëve për trajtimin e ujerave të ndotura të operatuara nga Bashkimi Evropian,

Ndihme shumë të cmueshme për qytetin e Prizrenit kemi Elaboratin detal të gjendjes së kanalizimeve problematike (20 km) përmes incizimeve CCTV realizuar gjatë vitit 2021 dhe zotimi i mjeteve financiare për ndërtimin e kanalizimeve të reja në gjatësi totale = 13 km në qytetin e Prizrenit, mbështetur nga Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Kosovës, sipas programi investive të fazave V dhe VI.

P.S: Plani i detajuar i investimeve 2022-2024 është i paraqitur në Shtesën e veçantë

2.6 Planifikimi i zvoglimit të humbjeve të ujit

Sfide serioze e Kompanise është zvoglimi i humbjeve të ujit perkatesisht humbjet teknike. Investimet ne keto projekte kerkojne impenjim te plote te te gjitha departamenteve dhe kosto te konsiderueshme financiare. Bazuar ne parametrat e percaktuara nga ARRU, sipas planifikimeve investive te PB, synohet qe deri në vitin 2024, ne faza vjetore, të zvogëlohen humbjet e ujit nga 54.6 % sa jane aktualisht ne 48.2 %

Gjithashtu sipas rekomandimeve te ARRU-se, investimet ne zvogelimin e humbjeve duhet te arrijne ne 1/3 e planifikimeve te gjithembarshme vjetore te investimeve kapitale te Kompanise. Konform ketyre caqeve jane perzgjedhur dhe projektet investive te cilat konsistojne ne:

- Zëvendësimin e rrjetit të amortizuar dhe vjetruar
- Avansimin e teknologjise detektuese dhe detektimi permanent i rrjedhjeve të ujit
- Evidentimim me kohe dhe intervenimi optimal eficient ne sanimim e rrjedhjeve nëntokësore dhe mbitokësore
- Prorittizimin e intervenimeve ne segmentet sipas evidences se programeve aplikative operuese MMS dhe MMA te prishjeve te shpeshta dhe me veshtiresi funksionimi.
- Instalimin e ujematesve te prodhimit dhe ujematesve zonal ne te gjitha pikat prodhuese e distributive te rrjetit te cilat do te mundesojne monitorimin e sakte te prodhimit dhe furnizimit te ujit,
- Instalimi i ujematesve te te gjithë konsumatorët dhe përpjekjet e panderprera që çdo konsumatori t'i matet sasia e ujit të shpenzuar dhe t'i bëhet faturimi në bazë të shpenzimit real,
- Dislokimi i ujematesve ekzistues nga prona private ne prone publike sa me afer gypit furnizues, me qellim te preventimit te keqperdorimeve apo nderhyrjeve te palejuara ne rrjetin e ujit te pijes,
- Intensifikimin e aktiviteteve per parafrimin permbylles te incizimit gjeodezik, digjitalizimit te rrjetit te ujesjellsesit e kanalizimit, perditesimit te te dhënave ne sistemin Auto Cad dhe sistemimi i tyre ne GIS,.
- Zonimet DMA dhe modelimet hidraulike.
- Planifikimi i resurseve njerëzore –trajnimet dhe avansimet profesionale

2.7 Plani i menaxhimit të aseteve

Gjendja aktuale e aseteve te kompanise është vleresuar nga OE i licencuar gjate vitit 2020, sipas kriterëve dhe standardeve aplikative per kete veprimtari,.

2.8 PRODHIMI – m3- 2022-2024

Tabela. 2 Prodhimi – 2022-2024

2022-2024					
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN					
No.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
		m3	m3	m3	m3
	NJËSIA P.				
1	PRIZREN	12,883,013	12,951,075	13,299,837	13,847,927
2	SUHAREKË	2,582,268	2,595,910	2,665,816	2,775,675
3	MALISHEVË	1,440,117	1,424,674	1,463,039	1,523,332
4	DRAGASH	1,063,737	1,069,357	1,098,154	1,143,409
5	MAMUSHË	-	133,493	133,493	142,737
6	TOTAL	17,969,135	18,174,509	18,660,339	19,433,079
	NDRYSHIMI		205,374	485,830	772,740
	NDRYSHIMI %		1.1%	2.7%	4.1%

Me qellim të pasqyrimin real të % se humbjeve referuar raportimeve mujore dhe periodike të prodhimit të ujit dhe trendit për tremujorin e fundit të vitit 2021 është shtuar kolona krahasuese me qellim sqarimi:

- Trendi i prodhimit sipas raportimeve për vitin 2021 duke llogaritur indeksin e rënies së prodhimit referuar TM4 të vitit 2020
- Trendi i prodhimit sipas raportimeve mujore për vitin 2021 duke llogaritur TM4 sipas trendit mesatar të prodhimit për periudhën Janar – Shtator 2021.

Realizimi i % së synuar të humbjeve për periudhën 2022 – 2024 paraqet sfida serioze dhe vështirë të realizueshme sidomos në aspektin teknik duke pasqyruar këta faktorë:

- Faturimi për vitin 2021 vështirë i arritshëm,
- Kosto shumë e lartë financiare për investime në zvogëlimin e humbjeve teknike,
- Mundësitë e limituara buxhetore të Kompanisë,
- Humbjet reale shumë më të mëdha se ato të raportuara.

3. DEPARTAMENTI RAJONAL PËR KONSUMATORË

Departamenti Rajonal për Konsumatorë bënë organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Siguron performancë të mirë të shërbimeve për konsumatorët, siguron komunikimin me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për leximin e matësve të ujit, shtypje të faturave për shërbimet e ofruara për konsumatorët, të rritë shkallën e arkëtimit, të shqyrtojë ankesat e pranuar nga konsumatorët . Njëkohësisht, urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhërit. Selektion dhe përgatit lëndët për konsumatorët debitor dhe të njëjtit i procedon në përmbarrim .Organizon punën e ekipeve të inspektoratit dhe shkyçje, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe urgjente. Pranon kërkesat për kyçje të reja, përgatitë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.

Departamenti me konsumatorë është departament, i cili punën me shërbimin me konsumatorë nëpër Njësit Operative e bënë përmes Udhëheqësit të Njësisë, ku udhëheq dhe përcjell shërbimin e faturimit, arkëtimin përmes arkave, lexuesve në teren, inspektoratit dhe shkyçjes. Nëpërmes shërbimit të inspektoratit identifikon konsumatorët ilegalë bën legalizimin e tyre duke i zbatuar vendimet dhe rregulloret e brendshme të kompanisë. Gjithashtu udhëheq procedurat për zgjidhjen e kontesteve me konsumatorë, kordinon aktivitetet me Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Pranon ankesat, kërkesat e konsumatorëve, ato i shqyrton në pajtim me politikën, procedurat dhe rregulloret në fuqi, për të gjitha ankesat komerciale. Për punët dhe aktivitetet e veta ky departament i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Objektivat e këtij departamenti janë të orientuara në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit , si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë. Departamenti me Konsumatorë edhe më tutje do të avansohet në punët dhe aktivitetet të cilat janë në përgjegjësinë e këtij Departamenti, duke përfshirë mirëmbajtjen e vazhdueshme elektronike të bazës së konsumatorëve si: kartelën e konsumatorit me transaksionet e bëra në vazhdimësi (faturimi, arkëtimi, saldo aktuale etj.), zgjerimin e mundësive rreth mënyrës së pagesave nga konsumatorët (rritjen e numrit të arkave brenda zonës së shërbimit, format elektronike të pagesës, raportimin dhe nxjerrjen e raporteve elektronike, pranimin dhe shqyrtimin më efikas dhe brenda afateve kohore të ankesave të konsumatorëve, rritjen e numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit etj.

3.1.1 Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve

Një ndër objektivat e këtij departamenti është edhe rritja e numrit të konsumatorëve si në zonën e shërbimit ashtu edhe zgjerimin e zonës së shërbimit. Ne tabelat vijuese mund të shihni parashikimin e rritjes së numrit të konsumatorëve të ndara në tri kategori: amvisëri, biznese dhe institucione. Kjo rritje paraqet numrin e konsumatorëve në zonën aktuale të shërbimit si rezultat i lidhjeve të reja, konsumatorëve të paautorizuar si dhe zgjerimin e zonës së shërbimit në zona rurale.

3.1.2 NUMRI I KONSUMATORËVE 2022 – 2024

Tabela. 3 Numri i konsumatorëve 2022-2024

2022-2024					
No.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
1	Shtëpiak	47,297	49,454	51,896	53,836
2	Ndryshimi		2,157	2,442	1,940
3	Ndryshi. %		4.6	4.9	3.7
4	Kome.-Indu.	6,136	6,210	6,333	6,429
5	Ndryshimi		74	123	96
6	Ndryshi. %		1.2	2.0	1.5
7	Institucional	340	351	378	398
8	Ndryshimi		11	27	20
9	Ndryshi. %		3.3	7.7	5.3
10	TOTAL	53,773	56,015	58,607	60,663
11	Ndryshimi		2,242	2,592	2,056
12	Ndryshi. %		4.2%	4.6%	3.5%

Te dhënat në tabelën 3.1.2 paraqesin numrin e konsumatorëve sipas muajve dhe njësisive që do të ofrohen shërbimet e ujësjellësit e që do të shtohen data bazës së konsumatorëve për faturim. Në kuadër të rritjes së numrit të konsumatorëve, rreth 40% do të jenë konsumatorë brenda zonës së shërbimit ndërsa pjesa tjetër si zgjerim i zonës (shtrirja e menaxhimit edhe në fshatra në zona rurale).

1. Objektivat kryesore në rritjen e numrit të konsumatorëve

Departamenti Rajonal me Konsumatorë, objektiv kryesore në rritjen e numrit të konsumatorëve ka dhënien e pëlqimeve për kyçje në rrjet, legalizimin e konsumatorëve të kyçur në rrjet si dhe marrjen nën menaxhim të zonave rurale, duke i përfillur ligjet dhe rregulloret ne fuqi.

2. Aktivitetet kryesore te planifikuara për arritjen e objektivave nga Departamenti Rajonal me Konsumatorë

- të procedoj në departamentet përkatëse kërkesat për kyçje në rrjet nga konsumatorët
- të regjistroj konsumatorët në data bazën e konsumatorëve të cilët janë pajisur me pëlqime për kyçje
- të legalizoj konsumatorët të cilët janë kyçur në shërbim sipas procedurave për legalizim
- rifreskimin e bazës së konsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: ndryshim të emrit, ndryshim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj.
- të regjistroj në data bazë konsumatorët e zonave rurale të marra në menaxhim të ujësjellësit

3. Aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se

- do të bëhen kontrole dhe inspektime rutinore dhe të planifikuara nga ekipet e inspektoratit për identifikimin dhe legalizimin e konsumatorëve, ku pritet të legalizohen diku 50-70 konsumatorë në muaj.
- do të procedohen dhe regjistrohen sa më shpejt si konsumatorë, personat që bëjnë kërkesa për kyçje në rrjet
- do të legalizohen të gjithë konsumatorët sipas procedurës së legalizimit

4. Rreziqet qe mund te ndikojnë ne mos arritjen e objektivave

- rritja e numrit të konsumatorëve pasiv
- zbulimi i vonshëm i konsumatorëve të cilët janë kyç në rrjet

3.1.3 FATURIMI m³ - 2022 – 2024

Tabela. 4 Faturimi m³ 2022-2024

2022-2024					
No.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
1	Shtëpiak	7,193,208	7,537,195	8,342,810	8,783,440
2	Ndryshimi		343,987	805,615	440,630
3	Ndry. %		4.8	10.7	5.3
4	Kome.-Indu.	719,077	659,573	708,997	710,225
5	Ndryshimi		(59,504)	49,424	1,228
6	Ndry. %		(8.3)	7.5	0.2
7	Institucional	423,432	536,764	547,608	548,750
8	Ndryshimi		113,332	10,844	1,142
9	Ndry. %		26.8	2.0	0.2
10	TOTAL	8,335,717	8,733,532	9,599,415	10,042,415
11	Ndryshimi		397,815	865,883	443,000
12	Ndry. %		4.8%	9.9%	4.6%

Gjatë periudhës 2022-2024 kemi planifikuar një rritje të faturimit në m³. Kjo rritje është rezultat i rritjes së numrit e konsumatorëve, duke u rritur me mesataren e konsumit për secilin konsumatorë krahasuar në periudhën paraprake. Edhe pse është një sfidë e madhe rritja e konsumit mesatar për konsumatorë, Departamenti me Konsumatorë në bashkëpunim të ngushtë me departamentet tjera do të rris aktivitetet në këtë drejtim si: ndërrimin e matësve jofunksional, riparimet sa më të shpejta të rrjedhjeve të ujit në teren, rritja e presionit të ujit në zonat me presion të ulët, legalizimin dhe regjistrimin e menjëhershëm të gjithë konsumatorëve të kyçur në rrjet të ujësjellësit.

1. Objektivat kryesore në rritjen e faturimit në m³

Departamenti Rajonal me Konsumatorë, objektiv kryesore ka rritjen e sasisë së ujit të faturuar tek konsumatorët duke ndikuar në rritjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve në furnizim me ujë të bollshëm dhe cilësor.

2. Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave

- të furnizoj konsumatorët ekzistues me ujë të bollshëm dhe cilësorë
- të furnizoj edhe konsumatorët e rijë në zonat e reja të shërbimit

- të marr në menaxhim zona të reja rurale apo edhe lagje të caktuara në qytet në të cilat operon duke e zgjeruar zonën e shërbimit e me këtë edhe rritjen e sasisë së faturuar të ujit në m³.
3. Aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-se
- të faturoj ujin nga lidhjet jashtë orës (by-pass) si faturim për kompensimin e dëmit të shkaktuar
 - inspektime të shpeshta do të bëhen për zbulim të lidhjeve pas orës, manipulime me ujëmatës, kontrollime të leximit të ujëmatësve etj.
 - do të legalizohen të gjithë konsumatorët sipas procedurës së legalizimit dhe të filloj faturimi
5. Rreziqet që mund të ndikojnë në mos arritjen e objektivave
- pamundësia e marrjes në menaxhim të zonave të reja të shërbimit e me këtë edhe pamundësia e faturimit
 - zbulimi i vonshëm i konsumatorëve të cilët janë kyçur në rrjet dhe me këtë edhe vonesë në fillimin e faturimit
 - pamundësia e zbulimit të lidhjeve ilegale tek konsumatorët ku për një kohë konsumatorët marrin shërbime pa u faturuar

3.1.4 PLANIFIKIMI I FATURIMIT € 2022-2024

Tabela. 5 Planifikimi i faturimit 2022-2024 (në €)

2022-2024					
No.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
1	Faturimi-€	5,324,596.58	5,837,885.03	6,138,143.10	6,376,945.25
2	Total- Shte.	4,087,019.72	4,497,607.40	4,784,480.00	5,016,706.00
3	Ndryshimi		410,587.68	286,872.60	232,226.00
4	Ndry. %		10.0%	6.4%	4.9%
5	Total- kome.	838,229.26	800,663.27	824,639.50	827,005.75
6	Ndryshimi		(37,565.99)	23,976.23	2,366.25
7	Ndry. %		-4.5%	3.0%	0.3%
8	Total-Inst.	399,347.60	539,614.36	529,023.60	533,233.50
9	Ndryshimi		140,266.76	(10,590.76)	4,209.90
10	Ndry. %		35.1%	-2.0%	0.8%
11	Te tjera	134,165.37	21,123.57	17,590.00	20,390.00
12	Total	5,458,761.95	5,859,008.60	6,155,733.10	6,397,335.25
13	Ndryshimi		400,246.65	296,724.50	241,602.15
14	Ndry. %		7.3%	5.1%	3.9%

1. Objektivat kryesore në faturim në euro

Departamenti Rajonal me Konsumatorë, ndër objektivat e saj ka rritjen e sasisë së ujit të furnizuar tek konsumatorët të shprehur në vlerë monetare (Euro). Faturimin për furnizim me shërbime të ujësjellësit dhe largimit të ujërave të zeza do ta bëjë duke u bazuar në urdhëresën tarifore të ARRU-së sipas viteve.

2. Aktivitetet kryesore të planifikuara për arritjen e objektivave

- të faturoj konsumatorët sipas tarifave të aprovuara nga ARRU.
- të furnizoj dhe faturoj edhe konsumatorët e rijë në zonat e reja të shërbimit
- rritja e numrit të konsumatorëve në bazën e të dhënave të konsumatorëve me të dhëna të reja për konsumatorët si: regjistrim të emrit, regjistrim të pronës së konsumatorëve, kategorive etj.
- të marr në menaxhim zona të reja rurale apo edhe lagje të caktuara në qytet në të cilat operon duke e zgjeruar zonën e shërbimit e me këtë edhe rritjen e sasisë së faturuar të ujit në m³. Të gjithë këta konsumatorë do të faturohen sipas urdhëresave tarifore të lëshuara nga ARRU.

3. Aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPPF-se të shprehur në euro

- me rritjen e numrit të konsumatorëve, faturimin në m³ kjo nënkupton edhe rritje të faturimit në euro dhe rënie të humbjeve financiare nga faturimi
- me legalizimin e të gjithë konsumatorët sipas procedurës së legalizimit nënkupton edhe shitje më të mëdha të ujit në euro
- me regjistrimin e të gjithë konsumatorëve të cilët kanë marrë pëlqim për kyqje në shërbime nënkupton edhe faturim të tyre e që ndikon në rritje të faturimit dhe njëkohësisht ulje të humbjeve financiare nga mungesa e faturimit

4. Rreziqet që mund të ndikojnë në mos arritjen e objektivave

- tarifatat më të ulëta ose të njëjta të aprovuara nga ARRU për periudhën 2022-2024
- pamundësia e marrjes në menaxhim të zonave të reja të shërbimit
- zbulimi i vonshëm i konsumatorëve të cilët janë kyçur në rrjet
- pamundësia e zbulimit të lidhjeve ilegale tek konsumatorët

3.1.5 PLANIFIKIMI I ARKËTIMIT € 2022-2024

Tabela. 6 Planifikimi i arkëtimit 2022-2024 (në Euro)

2022-2024					
No.	Të dhënat	2021	2022	2023	2024
1	Total- Shtëpiak	3,931,298.11	4,110,814.42	4,449,566.40	4,715,703.64
2	Ndryshimi		179,516.31	338,751.98	266,137.24
3	Ndry. %		4.6%	8.2%	6.0%
4	Total-Komercial-Industrial	761,723.24	778,808.89	808,146.71	810,465.64
5	Ndryshimi		17,085.65	29,337.82	2,318.93
6	Ndry. %		2.2%	3.8%	0.3%
7	Total Institucional	464,632.84	528,822.07	518,443.13	522,568.83
8	Ndryshimi		64,189.23	(10,378.94)	4,125.70
9	Ndry. %		13.8%	-2.0%	0.8%
10	Total - ujë	5,157,654.19	5,418,445.39	5,776,156.24	6,048,738.11
11	Ndryshimi		260,791.20	357,710.85	272,581.87
12	Ndry. %		5.1%	6.6%	4.7%
13	Te tjera	86,297.79	22,423.57	17,590.00	20,390.00
14	Ndryshimi		(63,874.22)	(4,833.57)	2,800.00
15	Ndry. %		-74.0%	-21.6%	15.9%
16	TOTAL	5,243,951.98	5,440,868.96	5,793,746.24	6,069,128.11
17	Ndryshimi		196,916.98	352,877.28	275,381.87
18	Ndry. %		3.8%	6.5%	4.8%

1. Objektivat kryesore në rritjen e arkëtimit

Departamenti Rajonal me Konsumatorë ndër objektivat e ka edhe rritjen e shumës së inkasuar nga sasia e ujit të furnizuar tek konsumatorët duke ndikuar në rritjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve në furnizim me ujë të bollshëm dhe cilësor. Arkëtimin e mjeteve nga shërbimet e ofruara tek konsumatorët kompania do ti shfrytëzoj për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimet e planifikuara sipas viteve.

2. Aktivitetet kryesore te planifikuara për arritjen e objektivave

- rritjen e mundësive për pagesa të konsumatorëve si: hapjen e arkave të reja ne zona dhe lokacione të përshtatshme për konsumatorët, rritjen e numrit te marrëveshjeve me institucionet mikro financiare, aplikacione për pagesa përmes telefonave mobil etj.
- rritje e aktiviteteve të shërbimit të lexuesve në leximin e ujëmatësve dhe dërgimin e faturave me rregull tek konsumatorët
- rritje e aktivitetit të ekipeve të inspektoratit në rritjen e presionit tek konsumatorët në pagesën e shërbimeve të ujësjellësit
- dërgimi i rasteve në përmbardim të konsumatorëve të cilët nuk i përgjigjen pagesave të mujore të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit
- dërgimi i mesazheve dhe thirrjet telefonike te shpeshta te konsumatorët të cilët kanë ri programuar borxhet e tyre.

3. Rreziqet qe mund te ndikojnë në mos arritjen e objektivave

- pamundësia e pagesës së konsumatorëve të obligimeve mujore
- rritje e numrit të konsumatorëve që jetojnë në asistencë sociale
- falimentimi i bizneseve të ndryshme te kategoria e bizneseve
- ndërrimi i lokacioneve të konsumatorëve dhe lënia e borxheve të papaguara në adresën paraprake.

3.1.6 Masat e planifikuara për arritjen e objektivave të përgjithshme nga Departamenti Rajonal me Konsumatorë

Me qëllim të rritjes së performancës së Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Leximi i saktë dhe i rregullt i konsumit të ujit të pijes,
- Disiplinimi i lexuesve për lexim sa më të saktë dhe azhur të ujëmatësve.
- Eliminimi në maksimum i faturimit paushall
- Ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
- Parandalimi dhe zvogëlimi i keqpërdorimeve përmes kontrolla të shpeshta tek konsumatorët
- Rritja e përgjegjësisë së ekipeve së inspektoratit në punët dhe aktivitetet e përditshme
- Rritja e numrit të rasteve për procedim në gjykatë që hasen në kyçje të paautorizuar.
- Hulumtimi i mundësive dhe metodave për arkëtimin e borxheve të vjetra
- Rritja e raporteve Konsumatorë-Kompani

- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës mbi rëndësinë, pagesat dhe kursimin e ujit të pijes, duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, PK-ne, Gjykatat dhe Mediat).

3.2 Gatishmëria për të paguar

Aktualisht pagesa e faturës së shërbimeve të ujit bëhet në të gjitha bankat komerciale, institucione mikro financiare, postë, në xhirollogaritë e KRU "Hidroregjioni Jugor" sha, që janë të shënuara në fatura dhe në arka tona në secilën njësi. Sportelet për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit aktualisht funksionojnë nëpër objektet e kompanisë dhe zyra të caktuara të shpërndara në lagje të caktuara brenda zonës së shërbimit. Planifikojmë që pagesa përmes arkave të zgjerohet edhe nëpër në zona tjera, ku konsumatorëve do të ju ofrohet mundësi për pagesën e shërbimeve të tyre, njëkohësisht në këto sportele konsumatori do të ketë mundësi që të shpreh ankesat e tyre për shërbimet tona. Për borxhet e akumuluar të konsumatorëve do tu ofrohet ri programimi i borxhit si dhe pagesa e tij në këste mujore. Për konsumatorët të cilët nuk përmbushin

Planifikohet të organizohen edhe kampanja të vetëdijesimit të konsumatorëve lidhur me

3.3 Trendët e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitin 2022 deri në vitin 2024 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arkëtimit nëpërmjet faturimit të matur të konsumatorëve. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetë qëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e arkëtimit;

- Implementimi i kodit të mirësjelljes së stafit të KRU "Hidroregjioni Jugor" ndaj konsumatorëve
- Ndërrimi i terreneve të inkasantëve për evitim të familjarizimit me konsumator
- Trajnimi i stafit, me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Funkcionalizimi dhe profesionalizimi i Zyrës Pritëse për Konsumatorë në secilën njësi operative
- Shqyrtimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve duke i penalizuar inkasantët për mos lexim
- Faturimi sipas shpenzimit (eliminimi i faturimit paushall)

- Marrja e masave ligjore sipas ARRU-së (procedurat e shkyçjes) për konsumatorët borxhlinjë
- Arkëtimi i mjeteve përmes përmbauesve privat
- Forcimi i mëtejshëm ekipeve të inspektoratit dhe ekipeve për shkyçje me mjete të nevojshme në terren
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

3.4 Kërkesat e rritjes së performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve

Funksionalizimi i Zyrës Pritëse për Konsumator, do ta mundësojë që me rastin e paraqitjes në zyrat e kompanisë për ankesën dhe kërkesën që ka, ta pret personi zyrtar i kompanisë dhe të ja bëjë regjistrimin e ankesës, gjithashtu kjo zyre do të ketë numrit të telefonit që do të jetë në dispozicion 24 orë për konsumatorin ku do ti lajmëroj të gjitha ankesat dhe kërkesat e tij. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve do të administrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe në një afat sa më të shkurtër do ti shqyrtojë ato dhe do ti përgjigjet konsumatorëve.

Disa shërbime si: dërgimi i faturës në e-mail të konsumatorit, plotësimi i ankesës online, mundësia e shikimit të kartelës online tashmë veç ju kanë ofruar konsumatorëve, Këto shërbime konsumatorët do t'i marrin pas regjistrimit të tyre në aplikacionin e vendosur online në ueb faqen e Kompanisë.

Me qëllim të zbatimit dhe shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve do të plotësohen dhe të organizohen trajnime të stafit të shërbimit me konsumatorë.

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania planifikon që të arrijë edhe përmirësimin e performancave sidomos në rritjen e numrit të konsumatorëve, masivizimin e konsumatorëve fiktiv, rritjen e sasisë së faturimit, zvogëlimin e keqpërdorimeve, zvogëlimin e lidhjeve ilegale, dhe përmirësimin e arkëtimit që është një ndër objektivat kryesore dhe të domosdoshme të kompanisë.

3.5 Rregullimi/konvertimi i lidhjeve të paligjshme.

Të gjitha lidhjet e paligjshme të cilat do të zbulohen nga ekipi i kontrollës do të legalizohen në pajtim me rregulloret e ARRU-së, duke paguar taksat dhe shpenzimet e nevojshme. ndërsa për lidhjet ilegale (by pas) para orëmatësit do të shkyçen nga rrjeti dhe rastet do të dërgohen në gjykatë.

3.6 Plani operacional

3.6.1 Planifikimi i zgjerimit te shërbimit

Shërbimi me konsumatorë krahas politikës zhvillimore që e ka KRU “Hidroregjioni Jugor”sha në zgjerimin e zonës së shërbimit edhe në zonat rurale që janë jashtë menaxhimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”sha, planifikon edhe në rritjen e stafit në këtë shërbim në të gjitha njësit operative si : futurist, inkasant dhe punëtor në kontroll/shkyçje.

Ne bashkëpunim me Komunitet me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit jemi pajtuar që fshatrat të cilat janë të gatshme dhe plotësojnë kushtet teknike dhe ekonomiko financiare mund të kalojnë nën shërbimin e Kompanisë.

3.6.2 PLANIFIKIMI I ZGJERIMIT TË ZONËS SË SHËRBIMEVE SIPAS NJËSIVE PUNUESE 2022-2024

Eshtë planifikuar që deri në vitin 2024 të zgjerohen shërbimet në

- Nj.P- Prizren për 7 fshata me rreth 1281 konsumatorë
- Nj.P- Suharekë për 8 fshata me rreth 3150 konsumatorë
- Nj.P- Malishevë për 25 fshata me rreth 1662 konsumatorë dhe

4. DEPARTAMENTI I FINANCEVE

Një ndër objektivat kryesore të kompanisë për vitet 2022-2024 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arkëtimit dhe zvogëlimi i shpenzimeve (aty ku është e mundur). Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetëqëndrueshme dhe e aftë të kryejë të gjitha shërbimet e domosdoshme.

4.1 Analiza e shpenzimeve

Sa i përket analizës së shpenzimeve Kompania “Hidroregjioni Jugor” SH.A do të financojë në mënyrë kualitative shpenzimet operative, të mirëmbajtjes.

Te gjitha shpenzimet, edhe ato qe i përkasin stafit do te orientohen ne funksionimin normal te të gjitha segmenteve te punës ne ujësjellës dhe prioritet kryesor është arritja e objektivave qe janë përcaktuar ne pjesën hyrëse te këtij Plani te Biznesit.

Një aktivitet tjetër në këtë drejtim është se Kompania do të përqendrohet në kursimin e energjisë elektrike ne disa stacione te pompimit, (Ndërrimi i pompave).

Kompania do të angazhohet qe te zvogëlojë edhe shpenzime tjera, aty ku është e mundur ne mënyrë qe me te hyrat e arkëtuara t'i mbulojë shpenzimet e rregullta operative; shpenzimet e kompensimit për punën jashtë orarit, shpenzimet për palët e treta etj.

4.2. Planifikimi i shpenzimeve – 2022- 2024

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN (ME IMPIANT)

Tabela. 7 Shpenzimet me impaiant

2022-2024					
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2021	JANAR-DHJETOR 2022	JANAR-DHJETOR 2023	JANAR-DHJETOR 2024
1	Total Shpenzimet Operative	4,004,364.03	4,621,804.31	4,795,799.13	4,976,396.31
2	Pagat	2,339,585.78	2,633,389.77	2,738,725.36	2,848,274.37
3	Rryma elektrike	899,099.02	1,045,470.95	1,087,289.79	1,130,781.38
4	Shpen. e derivateve	91,315.64	88,722.80	92,271.72	95,962.58
5	Mirem. dhe riparimet	191,372.85	329,158.31	331,447.29	333,470.39
6	Mirem. e automjeteve	67,707.26	75,657.68	78,683.99	81,831.35
7	Shpen.e taksave	99,029.05	99,346.12	103,319.97	107,452.77
8	Kemikaliet	29,389.20	37,288.32	38,779.86	40,331.05
9	Shpenzimet e tjera	286,865.23	312,770.35	325,281.16	338,292.41
2	Ndryshimi		617,440	173,995	180,597
3	Ndryshimi ne %		15.4%	3.8%	3.8%

4.3 Arsyeshmëria e shpenzimeve – 2022- 2024

Me rastin e përpilimit të Planit të Biznesit 2022-2024, Pozicioni i shpenzimeve për paga janë llogaritur për 347 punëtorë. Në këtë kategori janë të përfshira edhe:

Përshkrimi	Paga	Numri i punëtorëve	Muaj	Total
Paga mesatare	560	347	12	2,331,840.00
Ngritje e pagave për 10%	-	-	-	233,184.00
Janë paraparë nga 100.00 euro shpërblim për festa (vitin e ri, etj.) për punëtor	100	347	-	34,700.00
Pagat e drejtorëve të Bordit	400	6	12	28,800.00
Aftësimet profesionale seminare etj.	-	-	-	-
Shërbime profesionale	-	-	-	2,000.00
Shpërblime me rastin e pensionimit, për fatkeqësi eventuale. lëndime etj.	-	-	-	14,000.00
GJITHSEJË				2.644.524,00 €

Pozicioni i shpenzimeve tjera janë paraparë 18.000,00 €, për mjete higjienike, dezinfektues etj. Për masa tjera mbrojtëse duke llogaritur që situata pandemike do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022

Në pozicionin e shpenzimeve të përgjithshme të kompanisë nuk janë përfshirë edhe detyrimet kontigjente, të cilat paraqesin edhe rreziqe për kompaninë.

Obligimet ndaj KEK-ut të cilat janë me vendim gjykatë, por që kemi marrëveshje për pagim me këste:

Viti 2022

Kësti mujor – $10.064,00 \times 12 = 120.768,00\text{€}$

Viti 2023

Kësti mujor – $10.064,00 \times 12 = 120.768,00\text{€}$

Viti 2024

Kësti mujor – $10.064,00 \times 12 = 120.768,00\text{€}$

Obligimet ndaj punëtorëve që kanë vendim gjykatë (të pa përfunduar), të cilat kalojnë shumën mbi 94.000,00 €

4.4 Planifikimi i parallogaritjeve për kostot operative të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza

Projekti i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza është në fazën e fundit të implementimit, aktualisht jemi në fazën e testeve të garancionit dhe që të dy linjat si ajo e ujit të ndotur po ashtu edhe ajo e llumit janë dorëzuar tek HRJ. Konkretisht ITUN ka filluar operimin në dhjetor të vitit 2020 dhe deri më sot janë trajtuar afërsisht 4 milion m³ ujë. Pas përfundimit të procedurave të testeve dhe pranim-dorëzimeve do të bëhet optimizimi i operimit të ITUN-se

Në mënyrë që të ofrohet një buxhet i arsyeshëm për operimin dhe mirëmbajtjen e ITUZ, parallogaritjet janë grumbulluar nga kompanitë e kontraktuara ndërtimore dhe studimet e mëparshme, nga skema e pagave e HRJ-së, kontratat ekzistuese për energji elektrike dhe shërbimet tjera.

4.5. PARASHIKIMI I RREZIQEVE FINANCIARE PËR KRU HIDROREGJIONIN JUGOR SH.A

Momentalisht kompania ka 14 Konteste gjyqësore me vlerë rreth 53.382 Euro si dhe tri raste ku vlera e dëmit ende nuk është caktuar nga gjykata

4.6 Masat e planifikuara për arritjen e objektivave të Kompanisë

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Përmirësimi i leximit të saktë të konsumit të ujit të pijes,
- Marrja e masave ndëshkuese ndaj mos leximit apo leximit qëllimisht të gabuar.
- Zvogëlimi i faturimit paushall.
- Vendosja e ujëmatësve tek konsumatorët pa ujëmatës apo ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
- Zvogëlimi i keqpërdorimeve
- Forcimi i ekipës së kontrollës

- Marrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme.
- Përmirësimi i inkasimit.
- Përmirësimi i raporteve Konsumatorë-Kompani
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat).

4.7 Planifikimi i bonuseve dhe Shpërblimeve

Me qëllim të stimulimit dhe motivimit të stafit Kompania ka paraparë që në përfundim të secilit vit, varësisht nga performancat e arritura dhe bazuar edhe në rregulloren për shpërblime, të shpërblehen një numër i punëtorëve të dalluar

4.8 TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS – 2022-2024

Tabela. 8 Treguesit e Performances

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2022 - 2024			
		2021	2022	2023	2024
Uje i faturuar-si perqindje	%	46.9%	48.05%	51.43%	51.68%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	53.08%	51.95%	48.57%	48.32%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	87.26	92.82	94.10	94.85
Norma e arketimit - Amviserite	%	86.96	91.40	93.00	94.00
Norma e arketimit -Komercial-Industrial	%	88.44	97.27	98.00	98.00
Norma e arketimit -Institucional	%	87.87	98.00	98.00	98.00
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.05	1.18	1.21	1.22

5. PLANI I ZHVILLIMIT TË STAFIT

Raportet midis stafit do të përcaktohen në bazë të Rregullores së organizimit të brendshëm të Ujësjetës, ndërsa kryerja e detyrave të punës do të bëhet në varshmëri të përshkrimit detal të secilit vend të punës veç e veç. Në bazë të këtij përshkrimi do të përcaktohen edhe kushtet minimale (përgatitja profesionale, përvoja e kaluar në punë të ngjashme apo të përafërt, shkathësitë tjera të veçanta për lidhjen e marrëdhënies së punës, shkalla e përgjegjësisë të punëtorëve, niveli i pagesës si dhe hierarkia e dhënies së përgjegjësisë).

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirëmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve për vitin 2020-2022 varësisht nga numri i fshatrave që do të merren në menaxhim. Këta punëtorë do të jenë të angazhuar kryesisht në shërbimin e inkasimit dhe kontrollës në zonat e reja të shërbimit

Stafi i punësuar do të jete heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathësisë dhe racionalitetit në punë;
- Nga aspekti i përfaqësimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqësimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqësimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

5.1 NUMRI I PUNËTORËVE

5.4 Planifikimi i numrit të punëtorëve 2022-2024

Tabela. 9 Planifikimi i Personelit 2022-2024

Nr.	VITI	2021	2022	2023	2024
	N.PUNESE				
1	PRIZREN	258	264	273	280
2	SUHAREKË	37	39	42	45
3	DRAGASH	17	18	19	19
4	MALISHEVË	35	41	45	46
5	HIDROREGJIONI	347	362	379	390
6	NFRYSHIMI		15	17	11
7	NDRSHI. - %		4.3%	4.7%	2.9%

Numri i punëtorëve në Plan-Biznes 2020-2022 është planifikuar duke u marrë parasysh: formimi ekipës së veçantë për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale sipas projektit të zyrës Zvicerane, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.

Gjatë planifikimit të vendeve të punës dhe themelimit të marrëdhënies së punës do të respektohet Ligji i Punës., Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës.

Kompania nuk bënë asnjë dallim apo diskriminim në organizimin apo caktimin e obligimeve të punës në të gjitha shërbimet.

6. *Analiza SWOT*

Anët e forta

- Uji si element i domosdoshem për jetë
- Burimet e bollshme për ujë cilësor dhe kualitativ të pijes
- Staf me përvojë shumëvjeçare
- Gjendje e përmirësuar e infrastruktures elektro-hidraulike e stacioneve pompuese.
- Automatizimi dhe Eficienca optimale e paisjeve
- Kalibrimi i licencuar për ujëmatës
- Laboratori i akredituar për cilësi dhe analiza të ujit
- TI e avansuar për programe aplikative për GIS, MMS, MMA, MIA, Bench Marking, etj
- Trend në rritje të faturimit dhe arketimit nga viti në vit
- Aplikim i metodologjive të reja në faturim dhe pagesa të shërbimeve
- Treg monopolistik në ofrimin e shërbimeve
- Sistem i integruar i sistemit informativ financiar

Anët e dobëta

- Rjetat e ujësjellësit dhe kanalizimit të amortizuara dhe në gjendje të pavolitshme teknike e kondicionale.
-
- Prezenca e theksuar e materialeve azbest cement e çelik të amortizuara
- Humbjet e mëdha teknike të ujit të pijes
- Mosharmonizimi dhe mosrespektimi i kritereve dizajnuese e projektuese teknike gjatë investimeve komunale në infrastrukturen ujore.

- Mungese e kuadrave profesional ne sektor specifik dhe trajnimeve ne avansime profesionale.
- Largimi i kuadrave dhe emigrimi i shtreses potenciale per pune.
- Legjislatura qe pjeserisht mbulon kete fusheveprimtari dhe mosazhureteti i organeve te drejtesise per ndjekjen e keqperdoruesve dhe shkelesve te ligjit
 - *Kompania ka planifikuar qe me mjete vetanake por edhe me ndihmen e donatoreve te nderroje rrjetin ne vazhdimësi, varësisht nga mundësit financiare. (Shiko shtojcën e investimeve)*
 - *Permiresimi i bashkëpunimit me Invistitoret do te evitoje dobësitë ne investimet ne infrastrukturë*
 - *Me përmirësimin ekushteve te punës si dhe nivelizimin e te ardhurave personale planifikohet qe Kompania te jete nje mundësi me e mire per te aplikuar nga stafi profesional i profileve te ndryshme*

Mundësitë

- Projektdokumentacionet e gatshme investive
- Studimet fisibile dhe auditet e realizuara nga institutet kredibile dhe stafi inxhinierik i Kompanise.
- Infrastrukturë e qëndrueshme hidro - elektro teknike dhe makinerike
- Staf i profesionalizuar në sektorë per funksionim dhe operim efikas
- Pergjegjesi dhe perkushtim i stafit ne realizimn e objektivave te punes
- Tarifa të rregulluara nga ARRU
- Infrastrukturë të qëndrueshme për ofrimin e shërbimeve
- Zgjerim i vazhdueshëm i biznesit dhe i shërbimeve te konsumatorë të rinjë
- Staf i profesionalizuar në sektorë dhe shërbime të caktuara
- Përkushtim i stafit në sfida dhe përgjegjësi të reja të punës

Rreziqet

- Zvoglimi drastik i kapaciteteve ujore si rezultat i kushteve te pavolitshme atmosferike ne periudha kritike.
- Pamundesia financiare per realizimin e projekteve kruciale investive sipas PB dhe planifikimeve tjera per funksionim e operim efikas.
- Pamundësia e instalimit, nderrimit e kalibrimit te te gjithë ujematesve prodhues, zonal e te konsumatoreve sipas kriterëve rregullative e ankesave
- Efektet pandemike dhe efektet e ngajshme te natyres brenda dhe jashte dimensioneve njerezore
- Pamundësia teknike e leximit të të gjithë ujëmatësve mbrenda muajit

- Dyert e mbyllura dhe që nuk hapen nga konsumatorët në vazhdimësi
 - Emigrimi i njerëzve do të ndikoj në ulje të faturimit
 - Gjendja ekonomike dhe financiare e dobët e familjeve.
- Kompania ka planifikuar që në raste nevojë të ve në funksion burime alternative të furnizimit (stacioni i filtrimit me kapacitet mbi 100 l/sec.
 - Rritja e bashkëpunimit me donatore për rritjen e investimeve kapitale
 - Vendosja e pushtave dhe ujëmatësve në vende ku Kompania do të ketë qasje të përhershme për kontrolle dhe lexim.

7. Performancat operative dhe financiare

Tabela. 10 Performancat operative 2022-2024

Treguesit Operativë	Realizimi 2020	Realizimi 2021	Plani Biznesit 2022	Plani Biznesit 2023	Plani Biznesit 2024
Prodhimi i Ujit në m³	16.520.232	17,969,135	18,174,509	18,660,339	19,433,079
Faturimi i Ujit (%)	44.7%	46.9%	48.05%	51.43%	51.68%
Inkasimi i Ujit (%)	91.69%	87.26	92.82	94.10	94.85
Uji i pafaturuar (%)	55.3%	53.08%	51.95%	48.57%	48.32%
Testet e Dështuara (%)		0	0	0	0
Kons. me Ujëmatës (%)	98%	99%	100%	100%	100%
Numri i Konsumatorëve	52.322	53,773	56,015	58,607	60,663
Numri i Punëtorëve	337	331	362	379	390

Performancat financiare

Tabela. 11 Pasqyra e Pozites Financiare 2021 – 2022

Nr	Pershkrimi	2022	2021
1	PASURITE	€ -	€ -
2	Pasurie afatshkurtra	€ -	€ -
3	Paraja dhe ekuivaletet e parase	€ 682,091.23	€ 682,091.23
4	Investimet financiare afatshkurtra	€ 14,446.02	€ 14,446.02
5	Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	€ 5,428,849.51	€ 5,338,286.00
6	Stoqet	€ 539,018.51	€ 539,018.51
7	Pasurite tjera afatshkurtra	€ 8,869.24	€ 8,869.24
8	Gjithsej pasurite afatshkurtra 3 deri 7	€ 6,673,274.00	€ 6,582,711.51
9	Pasurite afatgjata	€ -	€ -
10	investimet ne pjesemerrje	€ -	€ -
11	Investimet ne filiale	€ -	€ -
12	Investimet afatgjata	€ -	€ -
13	Pasurite e trupezuara	€ 18,460,969.86	€ 19,811,111.86
14	Prona investuese	€ -	€ -
15	Investimet ne vijim	€ 6,201,225.70	€ 6,201,225.70
16	Pasurite e patrupezuare	€ -	€ -
17	Pasurite e shtyra tatimore	€ -	€ -
18	Pasurite tjera afatgjata	€ -	€ -
19	Gjithsej pasurite afatgjata 10 deri 18	€ 24,662,195.56	€ 26,012,337.56
20	Gjithsej pasurite (AKTIVA) 8+19	€ 31,335,470.07	€ 32,595,049.00
21	DETYRIMET DHE EKUITETI	€ -	€ -
22	DETYRIMET	€ -	€ -
23	Detyrimet afatshkurtra	€ -	€ -
24	Mbiterheqje bankare	€ -	€ -
25	Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	€ 1,197,968.08	€ 2,015,608.12
26	Kredite dhe huate pjesa afatshkurter	€ 11,034.14	€ 11,034.14
27	Interesi i pagueshem	€ -	€ -
28	Tatimi ne fitim i pagueshem	€ -	€ -
29	Provizionet afatshkurtra	€ -	€ -
30	Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkuter	€ -	€ -
31	Detyrime tjera afatshkurtra	€ 11,502.03	€ 11,502.03
32	Gjithsej detyrimet afatshkurtra 24 deri 31	€ 1,220,504.25	€ 2,038,144.29
33	Detyrimet afatgjata	€ -	€ -
34	Kredite dhe huate pjesa afatgjate	€ -	€ -
35	Provizionet afatgjata	€ -	€ -

36	Detyrime per lizingje kapitale	€ -	€ -
37	Detyrimet e shtyra tatimore	€ 1,533,595.51	€ 1,533,595.51
38	Detyrime tjera afatgjata	€ 12,946,430.36	€ 13,246,762.36
39	Gjithsej detyrimet afatgjata 34 deri 38	€ 14,480,025.87	€ 14,780,357.87
40	Gjithsej detyrimet 32+39	€ 15,700,530.12	€ 16,818,502.00
41	EKUITETI	€ -	€ -
42	Kapitali	€ 25,000.00	€ 25,000.00
43	Fitimet e mbajtura - humbja	€ (4,530,788.99)	€ (4,594,586.03)
44	Rezervat tjera	€ 20,140,728.94	€ 20,346,132.94
45	Gjithsej ekuiteti 42 deri 44	€ 15,634,939.95	€ 15,776,546.91
46	Total ekuiteti dhe detyrimet (PASIVA) 40+45	€ 31,335,470.07	€ 32,595,049.07

Pasqyra e te Ardhurave Gjitheperfshirese 2021 – 2022

Tabela. 12 Pasqyra e te ardhurave gjitheperfshirese 2021 – 2022

Nr	Pershkrimi	2022	2021
1	Te hyrat	€ -	€ -
2	Shitja e mallit dhe sherbimeve	€ 5,859,008.00	€ 5,458,761.46
3	Kostoja e shitjes	€ (4,621,804.00)	€ (4,004,364.03)
4	Fitimi/(humbja) bruto 2+3	€ 1,237,204.00	€ 1,454,397.43
5	Te ardhura tjera	€ 300,332.00	€ 300,332.40
6	Shpenzimet e shperndarjes	€ (1,144,738.00)	€ (1,144,738.47)
7	Shpenzimet administrative	€ -	€ -
8	Shpenzime tjera	€ (350,000.00)	€ (400,000.00)
9	Fitimi/(hubmja) operativ	€ 42,798.00	€ 209,991.36
10	Shpenzimet finaciare	€ -	€ -
11	Te ardhurat finaciare	€ -	€ -
12	Fitimi/(humbja) para tatimit	€ 42,798.00	€ 209,991.36
13	Shpenzimet e tatimit ne fitim	€ -	€ -
14	Fitimi/(humbja) e vitit	€ 42,798.00	€ 209,991.36
15	Te ardhura tjera gjitheperfshirese	€ -	€ -
16	diferencat kembimore nga perkthimi pasqyrave	€ -	€ -
17	Te ardhurat tjera gjithperfshirese te vitit	€ -	€ -
18	gjithsej te ardhurat/hubjet gjithperfshirese	€ 42,798.00	€ 209,991.36

INVESTIMET – 2022 – 2024

Tabela. 13 Investimet –KRU- 2022-2024

INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE		2022	2023	2024
Nr	NJËSIA			
1	NJ.P. PRIZREN	559,000.00	725,900.00	610,000.00
2	NJ.P- SUHAREKË	108,000.00	80,000.00	128,000.00
3	NJ.P. - MALISHEVË	78,100.00	40,000.00	90,000.00
4	NJ.P. - DRAGASH	25,000.00	19,000.00	25,000.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	5,000.00	2,000.00	28,000.00
KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN		775,100.00	866,900.00	881,000.00

Tabela. 14 Investimet –Grandet- 2022-2024

INVESTIMET NGA GRANDE/ DONA.		2022	2023	2024
Nr	NJËSIA			
1	NJ.P. PRIZREN	31,140,000.00	9,842,096.00	10,390,000.00
2	NJ.P- SUHAREKË	7,464,981.79	6,259,938.00	7,721,598.07
3	NJ.P. - MALISHEVË	6,739,900.00	3,879,000.00	5,800,000.00
4	NJ.P. - DRAGASH	255,000.00	200,000.00	200,000.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	15,000.00	17,500.00	117,500.00
KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN		45,614,881.79	20,198,534.00	24,229,098.07

8. Analizt e ujit - 2022 – 2024

Tabela. Analizat e ujit - 2022-2024

NJËSIA	LLOJI I TESTEVE	NR. I TESTEVE			
		2021	2022	2023	2024
Prizren	Bakteriologjike	832	840	848	856
	Fiziko-Kimike	832	840	848	856
Total		1,664	1,680	1,696	1,712
Suharekë	Bakteriologjike	107	109	111	112
	Fiziko-Kimike	107	109	111	112
Total		214	218	222	224
Dragash	Bakteriologjike	54	55	56	57
	Fiziko-Kimike	54	55	56	57
Total		108	110	112	114
Malishevë	Bakteriologjike	108	110	112	113
	Fiziko-Kimike	108	110	112	113
Total		216	220	224	226
Mamushë	Bakteriologjike	-	5	6	7
	Fiziko-Kimike	-	5	6	7
Total		-	10	12	14
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A	Bakteriologjike	1,101	1,119	1,133	1,145
	Fiziko-Kimike	1,101	1,119	1,133	1,145
TOTAL		2,202	2,238	2,266	2,290

KOMENT: Planifikohen te rriten numri i testeve sipas viteve si shkak edhe te zgjerimit te zonave te shërbimit por edhe te mbulimit me teste ne te gjitha zonat e shërbimit. Synimi i kompanisë eshte qe te vazhdohet qe te gjitha testet te plotësojnë standartet e kerkuar

Organogrami i KRU "Hidroregjioni Jugor", Sh. A

